

Njeriu ka prirje dhe e ka te nevojshme e të natyrshme, nëse ai nuk ndikimi të jashtëm nga shoqëria ose rrethanat e tij. Këto veçori janë cituar në disa hadithe autentike profetike.

Veprat (suneh)	Gjykimi	Shpjegim
[1] shkurtimi i mustaqeve	Është e rekomanduar (sunset). Është e urryer rruajtja plotësisht.	Suneti është që të shkurtohen mustaqet, të shkurtohen në mënyrë që të duken skajet e buzëve.
[2] Lëshimi e mjekrës.	Është e detyrueshme.	Ndalohet rruajtja e saj, pasi kjo bie ndesh me urdhrin profetik për lëshimin dhe zgjatimin e saj.
[3] Përdorimi i misvakut.	Është sunet i fortë	Përdorimi i një shkop të vogël nga pema "al-Arak" ose ndonjë tjetër. Është Sunet në çdo kohë, por më shumë në kohën e abdesit, namazit, hyrjes në shtëpi dhe xhamisë, leximit të Kuranit, zgjimit, para vdekjes ose kur goja ka erë.
[4] larja e hundës me ujë.	Nga sunetet e abdesit	Duke e tërhequr ujin me hundë më pas duke e nxjerrë atë përmes hundës.
[5] Prerja e thonjëve.	Është sunet i cili nuk bën të shtyhet për më shumë se 40 ditë	Prerja e thonjve dhe shkurtimi i tyre, përndryshe papastërtia grumbullohet poshtë tyre.
[6] pastrimi i nëngishtave.	Sunet (e pëlqyer)	Pastrimi i gishtërive dhe nyjave kur palosen sepse aty mund të grumbullohen papastërtitë.
[7] Mënjanimi e qimeve nga nënsqetullat.	Është sunet i cili nuk bën të shtyhet për më shumë se 40 ditë	Heqja e qimeve nën sqetull duke i depiluar ose rruar ato, me anë të largimit të tyre ke një higjienë të mirë dhe eliminon aromat e këqija.
[8] Mënjanimi i qimeve nga vendet e turpshme.	Është sunet i cili nuk bën të shtyhet për më shumë se 40 ditë	Këto janë qimet rreth organit gjenital. Ato mund të hiqen në forma të ndryshme, si p.sh. përdorimi i produkteve moderne.
[9] Pastrimi me ujë pas kryerjes së nevojës madhe.	Nga etika e kryerjes së nevojës madhe.	Pastrimi pas kryerjes së nevojës së madhe dhe asaj të vogël duke u pastruar me ujë etj. Pastrohen pjesët intime dhe rreth tyre.
[10] Shpëlarja e gojës.	Nga sunetet e abdesit.	Larje e gojës duke thithur ujë dhe më pas duke e nxjerrë jashtë duke bërë gargara .

Nga Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Dhjetë gjëra janë prej fitres: shkurtimi i mustaqeve, rritja e mjekrës, përdorimi i misvakut, shpëlarja e hundës, prerja e thonjve, larja nën gishtave, mënjanimi i qimeve të sqetullave, mënjanimi i qimeve tek vendet e turpshme dhe larja e vendeve të jashtëqitjes me ujë". Zekerija ka thënë: Mus'abi tha: "E kam harruar të dhjetën, përveç nëse bëhet fjalë për shpëlarjen e gojës". Kutejbe ka shtuar: Se Vaki'u ka thënë: "Të përdorësh ujin do të thotë të pastrosh pjesët e turpshme me ujë". Transmeton Muslimi

[11] Synetllëku.	Është e detyrueshme për burrat dhe epëlqyeshme për gratë në rast nevoje	Kjo përfshin prerjen e lafshës që mbulon organin, në mënyrë që papastërtitë të mos grumbullohen atje dhe për tu pastruar pas kryerjes së urinës.
-------------------------	---	--

Nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, Profeti alejhi selam ka thënë: "Pesë gjëra janë prej fitres: synetia..." Transmeton nga Buhari dhe Muslimi.

Burimi: Marrë nga shpjegimi i librit Fet'hu El muijn Fi tekrijb menhexh Es-salikinë ue teudijh Ed din El Fikh Fi Dijn e Shejhut Hejthem Serhan (Allahu e ruajtë) **Kopja e parë.**

Kontakt:

Lien: <https://alsarhaan.com>